FIF - KRK - Hua për NMVM II

Lokacioni:	Kosova
Numri i projektit:	51780
Sektori i biznesit:	Institucionet financiare
Lloji i njoftimit:	Privat
Kategoria mjedisore:	IF
Data e aprovimit:	18 shkurt 2020
Statusi:	**Disbursim**
Data DPP e shpalosur në gjuhën angleze:	14 shkurt 2020

Sipas nenit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informatë: "Për Projektet e aprovuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve e ka deleguar autoritetin e aprovimit, DPP-ja do t'i shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për mos-kundërshtim shtetit anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH".

Përshkrimi i projektit

Sigurimi i një huaje seniore të pasiguruar deri në 3 milion EUR që do të jepet në dy transhe (transheja e parë prej 2 milion EUR dhe transheja e dytë prej 1 milion EUR e pa-zotuar) nën Kornizën e Ndërmjetësuesve Financiar ("FIF"). Huaja do të jetë 3 vjeçare, e përbërë nga 1 vjet grejs periudhë dhe 2 vjet për shlyerjen e kryegjësë.

Objektivat e projektit

Mjetet nga investimi i Bankës do të përdoren për të siguruar fonde afatgjata për NVMM-të e pranueshme në Kosovë; huaja do ta përkrahë zgjerimin e huazimit të KRK për NMVM dhe do ta zgjatë maturitetin e detyrimeve të subjektit.

Ndikimi i tranzicionit

Nota ETI: 60

Konkurrues: Projekti e përkrahë huazimin e KRK për NVM-të private në Kosovë, ku boshllëqet janë të mëdha, nga fonde të shumta të BERZH-it. Projekti fokusohet në shtrirjen dhe tërheqjen rajonale të klientëve të rinj të NVM-ve.
Rezilienca: projekti synon që të sigurojë praktika të kujdesshme të huazimit dhe cilësinë e duhur të portofolit.

Informatat për klientin

KREDITIMI RURAL I KOSOVES LLC

Kreditimi Rural i Kosovës, LLC ("KRK") është institucioni i tretë më i madh mikrofinanciar ("IMF") në Kosovë me hua bruto dhe i vetmi IMF i organizuar aktualisht si kompani me përgjegjësi të kufizuar. KRK operon që nga viti 2000 dhe siguron qasje në financa për individë me të ardhura të ulëta në viset rurale dhe urbane të Kosovës, duke i dhënë prioritet sektorit të bujqësisë. KRK ka

një rrjet prej 26 degëve në tërë shtetin dhe 244 të punësuar deri në VE 2019. KRK ka bazë të fortë të aksionarëve të përbërë nga EFSE (42.2%), FMO (29.2%), SIDI (17.4%) dhe Credit Cooperatif (11.2%). Ekspozimi ekzistues që nga Shkurti 2020: 2.4 milion EUR

Përmbledhje e financimit nga BERZH

3,000,000,00 EUR

Kostoja totale e projektit

3,000,000,00 EUR

Shtueshmëria

- **Struktura e financimit:** huaja e BERZH-it do të sigurojë financimin afatgjatë të shumë-nevojshëm i cili do të ndihmojë në adresimin e çështjeve të disponueshmërisë së kufizuar të financimit afatmesëm dhe afatgjatë për institucionet që nuk marrin depozita në Kosovë.

- Vendosja e standardit: Nga KRK do të kërkohet që të veprojë në përputhje me Kërkesat e Performancës së BERZH për IF. Nga të gjitha nën-projektet dhe nën-huamarrësit do të kërkohet të jenë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Deklaratën e Politikave të FIF.

Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar IF (PMS 2019). KRK është klient ekzistues dhe është në përputhje me KP 2, 4 dhe 9, të verifikuara duke shqyrtuar raportin e fundit SI për 2018. Nga KRK do të kërkohet që të vazhdojë të jetë në përputhje me Procedurat e Menaxhimit të Riskut M&S të BERZH-it për Huatë për Korporata, NVM dhe Mikro, si dhe KP-të e zbatueshme, dhe të parashtrojë raportet vjetore të M&S pranë Bankës.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Grantit

Nuk ka.

Informatat kontaktuese të kompanisë

Burbuqe Berisha burbuqe.berisha@krk-ks.com http://krk-ks.com/en/

Përditësimi i fundit i DPP

14 shkurt 2020

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH.

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së Qasjes në Informacion; dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutemi vizitoni faqen e internetit të Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit për të paraqitur një kërkesë për shqyrtimpërmes formularit konfidencial në internet, me postë elektronike, postë apo telefon. MPPP është i gatshëm të diskutojë shqetësimet tuaja dhe t'i përgjigjet pyetjeve që mund të keni për ngritjen dhe trajtimin e kërkesave që ndjekin udhëzimet e Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit. Identiteti i Palës që kërkon informacion mund të mbahet konfidencial sipas kërkesës.